



Të dhëna për kompaninë

Kompania	FunFood shpk
Vendndodhja	Tirane
Industria	Administrim biznesi

Detaje të pozicionit

Tipi i punës	Kohe e plote	Letër interesi	Po
Eksperiencë	Mesatare (3 - 10 vite)	Rroga mujore	—
Kërkohet foto	Po	Data e përfundimit	08-02-2017
Letër motivimi	Jo	Data e fillimit të punës	

Përshkrimi

FunFood shpk është në kërkim të një Menaxheri te Operacioneve për zinxhirin e saj Fast Food për zonën e Tiranës. Menaxheri i Operacioneve do të jete përgjegjës për të gjitha aspektet e perditshme ne drejtimin e njesive, duke përfshirë shitjet, shërbimi ndaj klientit, kontrollin e cilësisë, operacionet, zhvillimin e personelit dhe trajnimin.

Menaxheri i Operacioneve do të jetë përgjegjës për arritjen e objektivave te njesive te shitjes për të gjitha linjat e biznesit.

Detyrat

PERGJEGJESITE OPERACIONALE:

- Te drejtoje, organizoje, koordinoje veprimtarine e perditshme te njesive te shitjes ne bashkepunim me pergjegjesit e tyre.
- Te tregojë lidershhip në menaxhim, trajnim dhe motivim.
- I afte në marketingun e produktit dhe cilësisë së shërbimit të kompanisë
- Përgjegjës për kërkimin, zgjedhjen, rekrutimin, trajnimin, vlerësimin, motivimin e personelit dhe standardet e performancës të punës së individëve brenda ekipit.
- Përgjegjës për të gjitha aktivitetet e marketingut dhe reklamave.
- Te mbikëqyrë cilësinë e produkteve dhe sasitë e tyre për të optimizuar inventarin.
- Te kryje kontrole të shpeshta për të siguruar cilësi të qëndrueshme të shërbimeve.
- Te siguroje përputhjen me të gjitha rregullat e shëndetit dhe sigurisë, dhe cdo element tjetër te nevojshem.
- Të sigurojë raporte mujore mbi ecurinë, progresin kundrejt planeve të veprimit dhe buxhetet.
- I gatshëm dhe të aftë për të punuar jashtë orarit.

PERGJEGJESITE FINANCIARE:

- Të punojë me Drejtorin e Pergjithshem për të zhvilluar dhe percaktuar objektivat e një plani nje dhe shume vjecar.
- Të rise shitjet e produktit në përputhje me planin e biznesit të kompanisë dhe objektivat dhe të marre persiper veprime të hershme korrigjuese, nëse nevojitet.
- Te menaxhoje performancën financiare te njesive te shitjes.
- Të punojë me Drejtorin e Pergjithshem për të zhvilluar politikat e çmimeve për produktet dhe shërbimet.
- Të identifikoje performancën e dobët të njesive dhe të këshillojë mbi veprimet e nevojshme për përmirësimin.

- Te siguroje, te përpunojë dhe te analizoje informacionin per planifikimin dhe buxhetimin.
- Të vlerësojë kushtet e tregut, veprimtarinë konkurruese, profilet e konsumit, etj
- Te zgjedhe ose krijojë artikuj/produkte/menu të suksesshme në bazë të shumë faktorëve, dhe të caktojë çmimet në bazë të analizave të kostos
- Të rishikojë dhe monitorojë shpenzimet për të siguruar që ata të jenë brenda kufizimeve buxhetore. Të punojë për të përmirësuar performancën.
- I afte në identifikimin e kanaleve të reja të shitjes.

Kualifikimet / Kërkesat

1. Aftësi të forta komunikimi, organizative, operacionale dhe personale.
2. Aftësi të zhvilluara analitike dhe zgjidhjes së problemeve.
3. Aftësi të forta ndërpersonale dhe të lidhshimit.
4. Vëmendje ndaj detajeve.
5. Orientim te fortë shërbimi ndaj klientit.
6. Përvoja te mëparshme në industrinë Fast Food ose Restoranteve ne pergjithesi.
7. Leje drejtimi automjeti.

Shënime

Të gjithë të interesuarit duhet të dërgojnë CV në email: **funfoodalbania@gmail.com** me subjekt Menaxheri i Operacioneve ose të kontaktojnë në numrin e telefonit +355 **68 20 24583**



Duapune.com është konceptuar si një pikë takimi e kërkesave dhe ofertave të tregut të punës, ku punëkërkesit dhe punëdhënësit gjejnë njeri-tjetrin.

Linku i aplikimit: <https://duapune.com/jobs/23361>



Apliko